



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 1517 prot

Durrës, më 8.11.2021

VENDIM

Nr. 14, datë 8.11.2021.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Urdhërit nr 413, datë 24.09.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", të shkresës nr. 1336 datë 08.10.2021 ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të Urdhërit nr. 345 datë 06.11.2021, të Statutit të Universitetit, dhe të Rregullores së Universitetit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 08.11.2021,

VENDOSI:

1. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, Drejtorisë së Kurrikulës së Standardeve të Cilësisë për të ndjekur në vazhdimësi procesin e mësimdhënies.
2. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, për marrjen e masave për fillimin e procesit mësimor në ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2021-2022.
3. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, në rastet e veçanta, të marrin masa në bashkëpunim me drejtuesit e njësive bazë që mësimi të zhvillohet online.
4. Miratimin e listave për lektorët e jashtëm për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022 sipas listave të paraqitura nga Dekanët e fakulteteve, dhe ngarkimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike për hartimin e kontratave të lektorëve me kohë të pjesshme sipas nevojave të Fakulteteve.

5. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve dhe Qendrës për Edukim në Vazhdim për përcjelljen e nevojave për trajnim të stafit akademik me qëllim finalizimin e një kalendari të posaçëm trajnimi dhe mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave me Universitetet e rajonit e më gjerë.
6. Ngarkimin e Administratorit, dekanëve të fakulteteve për ngritjen e qëndrave të shërbimit studentor.
7. Ngarkimin e zv. Rektores për Marrëdhëniet Institucionale dhe Administratorit për ndjekjen e procedurave për pasurimin e bibliotekës së Universitetit me tituj të rinj, sipas nevojave të fakulteteve.
8. Ngarkimin e Drejtorisë së Shërbimeve Akademike për shpalljen dhe realizimin e zgjedhjeve të qeverisë Studentore në çdo Fakultet.
9. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve dhe drejtuesit e njësisë bazë për zhvillimin e zgjedhjeve për drejtues të grupeve mësimore kërkimore, ku votimi kryhet brenda grupeve mësimore kërkimore.
10. Ngarkimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike për hartimin e procedurës për zhvillimin e zgjedhjeve për drejtues të grupeve mësimore kërkimore.
11. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Dekanët e fakulteteve
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike
 - Drejtoria e Shërbimeve të Mbështetëse
 - Drejtoria e Shërbimeve Akademike.
 - Drejtoria e Kurrikulës së Standardeve të Cilësisë
 - Drejtuesit e Njësive Bazë
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

